



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

Berat, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

RELACION

**MBI MIRATIMIN E ZONAVE TË PARKIMIT ME PAGESE, TARIFAVE TË PARKIMIT PUBLIK NË “PARKIMI GORICË ” DHE PARKIMI VERIOR I GORICËS, SI DHE NJË SHITESË NË NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË BASHKISË BERAT, PËR MENAXHIMIN E TYRE.**

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Berat ka në pronësi dy ambiente publike pranë Urës së Goricës, “Parkimi Goricë” i cili është ndërtuar në kuadër të projektit “Rehabilitimi i siluetës urbane në lagjen Goricë” me 63 vende parkimi, gjithashtu është duke krijuar edhe Parkimin publik në pjesën veriore të Goricës (pranë rrethrotullimit ish-SHIKU) me 32 vende parkimi.

1-Parkimi në Goricë deri tani ka funksionuar si parkim pa pagesë për qytetarët dhe turistët që vizitojnë qytetin. Lagja Goricë është një lagje pjesë e Ansamblit muzeal të qytetit të Beratit dhe një atraksion turistik i rëndësishëm në qytet.

Duke parë fluksin e mjeteve që mbërrin në lagje është e nevojshme që të disiplinohet ky fluks duke i dhënë prioritet qytetarëve dhe bizneseve.

2- Parkimi në pjesën veriore të Goricës ( pranë rrethrotullimit ish-SHIKU) do të vihet në funksion së shpejti dhe i shërben gjithë fluksit të mjeteve të cilët aksesojnë zonën muzeale të Goricës dhe Mangalemit, por edhe në lagjen *Dëshmorët e Kombit*.

Të dy parkimet do kenë logjistikën e nevojshme me vend –qëndrime për rojet, kolona hyrëse dhe dalje, barriera të kompjuterizuar, lexues kartash për pagesë dhe skanime barcodi.

Duke studiuar me kujdes fluksin e mjeteve, lëvizjen e banorëve dhe turistëve, nevojat, si dhe duke marrë parasysh kostot dhe përfitimet, ju propozojmë tarifën e mëposhtme për të dy parkimet:

Tarifat :

0 - 3 orë	100 lekë
3-6 orë	200 lekë
6-8 orë	300 lekë
8-24 orë	600 lekë

Abone mujore	2500 lekë/muj. Nëse paguhet 6 mujore
Abone mujore	4500 lekë/muj . Nëse paguhet 1 mujore

Për menaxhimin e Parkimeve më sipër do nevojitet një staf i përbërë nga një (1) përgjegjës dhe (3) tre punonjës, të cilët do jenë pjesë e strukturës së bashkisë Berat.

Ju propozojmë miratimin e dy vend parkimeve më sipër, të tarifave përkatëse të dy parkimeve, si dhe miratimin shtesë personeli, shtesë në numrin e përgjithshëm të punonjësve me 4 (katër) punonjës për menaxhimin e dy parkimeve. Bazuar në përllogaritjet e kapaciteteve të këtyre parkimeve, si dhe tarifave të propozuara, efektet financiare të kostove për pagesat e këtyre punonjësve do të mbulohen nga vetë të ardhurat e krijuara nga parkimet e propozuara.

Faleminderit

**KRYETARI I BASHKISË**  
Ervin DEMO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

**RELACION  
MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE FINANCIARE  
NË RASTE TË VEÇANTA ZNJ. RAJMONDA FEKA**

Drejtorja e Shërbimit Social dhe Drejtorja e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga Znj. Rajmonda Feka, Nr. 2960 Prot, datë 30.05.2024, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c, ligjin 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqërore komunitare e rezidenciale, kriteret procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e tyre për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, VKB nr.60 datë 21.12.2023 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026”.

**JU RELATOI:**

Të nderuar këshilltarë,

**Znj. Rajmonda Feka** jetonë në lagjien nr. 2 “Jani Vruho”, Rruga: “E Burimit”, në katin e 4 të një pallati ekzistues, banesa në të cilën jetonë familja Feka në bashkëpronësi është e tipologjisë 2+1, me orendi dhe kushte të vjetëruara. Në këtë banesë jetojnë tre familje të ndara pasi vllai dhe motra e znj. Feka kanë familje më vete. Znj. Feka është kryefamiljare kjo vërtetuar nga (çertifikata bashkëngjitur).

Znj. Rajmonda Feka është me arsim të lartë por prej afro 12 (dymbëdhjet) vitesh nuk është integruar në tregun e punës. Të ardhurat që ka, është vetëm ndihmë ekonomike në masën 2.178 (dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë.

Strukturat e Shërbimit Social pasi administruan kërkesën e znj. Feka realizuan vlerësimin social-ekonomik të kësaj familje. Gjatë vlerësimit vihet re vështirësi ekonomike pasi e ardhura e vetme që ka znj. Feka është ndihma ekonomike. Mungesa e të ardhurave e ka

penguar që të kujdeset për vetën dhe shëndetin e saj, në pa mundësi ekonomike ajo e ka të pa mundur të marrë medikamentet e nevojshme.

Nga administrimi i dokumentacionit shëndetësor vërtetohet që znj. Feka prej vitesh vuan nga diabeti i tipit dy për të cilin merr dhe medikamentet përkatëse. Sëmundja dhe mos kurrimi në kohë si pasojë e mungesës së të ardhurave i kanë sjell probleme serioze në shikim ku znj. Feka e ka urgjente kryerjen e një injeksioni të kushtueshëm i cili nuk rimburohet për të mos rrezikuar shikimin. Diagnoza që asaj i rrezikon shikimin është (retinopathy diabetike, proliferative, emoragji vitreale, aflibercept intravitreal).

Përpost injeksionit të kushtueshëm ajo duhet të nënshtrohet dhe skanerit okulistik i cili ka një kosto të pa përballueshme për të ardhurat që ka znj. Rajmonda. Gjithashtu gama e medikamenteve që ajo kurohet të tipit si: floksigen nuk është i rimursueshëm nga libri i barnave.

***Të ndodhur në këto kushte duke u bazuar dhe në kërkesën e bërë nga Znj. Rajmonda Feka, vlerësimin social-ekonomik mbi nevojat nga strukturat e shërbimit social, vështirësin social-***

*ekonomike, kushtet ku jetonë familja dhe dokumentacionin shëndetësor e paraqitur, propozojmë që znj Rajmonda Feka të mbështetet në masën e 50.000 (pesë dhjetë mijë) lekë .*

Bashkëngjitur gjeni:

1. Dokumentacion shëndetësor.
2. Çertifikatë familjare/ kopje të ID kartave .
3. Vërtetimi mbi masën e ndihmës ekonomike.
4. Vlerësimi social-ekonomik nga administrator i N.E.

**DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**  
Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROJEKT- VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE FINANCIARE  
NË RASTE TË VEÇANTA ZNJ. RAJMONDA FEKA**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c, ligjin 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqërore komunitare e rezidenciale, kriteret procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e tyre për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, VKB nr.60 datë 21.12.2023 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026”.

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në raste të veçanta, për shtetasen Rajmonda Feka në shumën 50.000 (pesëdhjet mijë) lekë .
2. Shuma prej lekë 100.000 (njëqind mijë) lekë, do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2024.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

Ervin Ceca

Këshilli i Bashkisë e miratoi me : \_\_\_\_ Vota Pro, \_\_\_\_ Vota Kundër, \_\_\_\_ Vota Abstenim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
RELACION

MBI MIRATIMIN E PROJEKTIT “NDËRTIMI I IMPIANTIT TË RI TË TRAJTIMIT TË UJRAVE TË NDOTURA DHE NDËRHYRJET NË RRJETIN E KANALIZIMEVE BASHKIA BERAT’ DHE MIRATIMIN NË PARIM TË PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT

Të nderuar Këshilltarë ,

Bashkia Berat është përfituese e projektit “Ndërtimi i Impiantit të ri të trajtimit të ujrave të ndotura dhe ndërhyrjet në rrjetin e kanalizimeve Bashkia Berat”, i cili financohet nga Programi i Performancës dhe Investimeve të Ujit (MIP V), financuar bashkarisht nga hua dhe grant nga Qeveria Gjermane nëpërmjet Bankës Europiane për Zhvillim ( KFW), grant i BE programi IPA 2018,si dhe grant nga Qeveria Zviceriane nëpërmjet Sekretariatit të Shtetit Zvicerian për Çështjet Ekonomike ( SECO), të gjitha nëpërmjet Ministrisë Shqiptare të Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkive Berat dhe Kuçovë.

Koordinatorja e programit është AKUM ( Agjensia Kombëtare Shqiptare për Ujësjellës Kanalizime) dhe agjensia ekzekutive është SHAUK Berat- Kucovë.

Shuma totale e financimit e projektit për ndërhyrjet në Berat dhe Kucovë është 26 milionë euro.

Studimi i fizibilitetit dhe projekti i zbatimit është përfunduar dhe së shpejti pritet të nisin procedurat e prokurimit nga KFW.

Projekti do të bëjë të mundur:grumbullimin,transportimin dhe trajtimin e ujrave të zeza nga pikëpamja mjedisore dhe ekonomisht të përbalueshme dhe të qëndrueshme për qytetin e Beratit dhe shmangien e ndotjes së lumit Osum nga derdhjet e ujrave të ndotura.

Aktualisht një pjesë e ujrave të zeza derdhen në Lumin Osum në disa segmente. Projekti do të bëjë të mundur ndërtimin e 4 pikave të reja të shkarkimit të kombinuara, të cilat do eliminojnë derdhjen e tyre në lumin Osum.

Projekti parashikon:

1-Ndërtimin e Impiantit të Ujrave të Ndotura i cili do të ndërtohet në territorin e fshatit Orizaj,me kapacitet 46,000 PE ( për numër popullsie) me trajtim mekanik dhe biologjik dhe trajtim të llumit,  
2-Masat në rrjetin e kanalizimeve të cilat përfshijnë: grumbulluesin kryesor në Impiantin e ri, Dhomën e Grumbullimit në Rrugën ‘ Bostanet’ Rajoni 1, Stacionin e Pompimit në Goricë dhe rrjetin e presionit ngjitur me të.

3-Ndërtimin e 4 pikave të shkarkimit në Shëtitoren “Osumi” pranë Bibliotekës, pranë Parkut Qendror,pranë Parkut “Dua të luaj” dhe në rrugën “Iliria” në lagjen “Deshmorët e Kombit”.

4. Kolektori kryesor i ujrave të zeza në Goricë, do lidhet me një stacion të ri pompimi të ujrave të ndotura, dhe prej aty nëpërmjet një tubi presioni do kalojnë përmes Urës së Re, duke e lidhur stacionin e pompimit me kolektorin kryesor të ujrave të zeza.

Nëpërmjet këtij materiali, ju propozojmë miratimin në parim të projektit, si edhe miratimi në parim për Bashkinë Berat për të avancuar me procedurat e shpronësimit të objekteve, të cilat mund të preken nga ky investim, të cilat do të identifikohen nga grupi i punës së Bashkisë Berat.  
Faleminderit

**KRYETARI I BASHKISË**  
Ervin DEMO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE, PRONAVE, TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

## RELACION

**MBI MIRATIMIN E MARËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME ASHK "PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE, BRENDA TERRITORIT TË BASHKISË, NË ZONAT ME PRIORITET ZHVILLIMI URBAN DHE ZONAT INFORMALE BANIMI" DHE NJË SHITESË NË NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË BASHKISË BERAT, PËR MENAXHIMIN E PROCESIT**

### **Të nderuar Këshilltarë !**

Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 435, datë 26.06.2024 "Për një shtesë në Vendimin nr. 867, datë 10.12.2014, "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e Administratës shtetërore" ka shtuar kreun V me objekt "Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore në funksion të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje", në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale banimi.

Në pikën 14 të këtij vendimi shprehet se: ASHK-ja u propozon bashkive lidhjen e marrëveshjes (Shtojca A, bashkëlidhur vendimit), brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Qëllimi i marrëveshjes është të parashikojë mënyrën e bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit ndërmjet palëve, në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi, për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe të trajtimit me prioritet të procedurave administrative të papërfunduara, për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale banimi.

Marrëveshja lidhet bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin 111/2018 "Për kadastrën", ligjin 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH", ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe ligjin 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".

Objekt i akt-marrëveshjes është përcaktimi i rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit midis ASHK-së dhe Bashkisë Berat.

Në nenin 6 të marrëveshjes janë përcaktuar në mënyrë të detajuar "Angazhimet e palëve" të Bashkisë dhe të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës .

Në nenin 4, nenin 7 pika d), të akt-marrëveshjes është parashikuar, që midis dy institucioneve do të të ketë ndërveprim për evidentimin në terren të ndërtimeve pa leje nëpërmjet burimeve njerëzore të të dy institucioneve. Duke marrë shkas nga kjo, është e domosdoshme shtimi

i dy specialistëve, të atashuar pranë Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, të cilët do të jenë të angazhuar vetëm me këtë detyrë, evidentimin në terren të ndërtimeve pa leje, shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve, administrimin e të dhënave, informimin e subjekteve që kanë paraqitur kërkesë për legalizim, asistimin dhe mbështetjen për plotësimin e dokumentacionit nga subjektet, përcjelljen e infomacionit të grumbulluar tek ASHK-ja, ndërlidhjen mes ASHK-së dhe komunitetit, si dhe mbajtjen e dokumentacionit që do të jetë produkt i këtij procesi.

Miratimi i kësaj marrëveshje nga ana Juaj dhe më pas nënshkrimi nga Kryetari i Bashkisë është hapi i parë për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe të trajtimit me proritete të procedurave administrative të papërfunduara, për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me proritete zhvillimi urban dhe zonat informale banimi.

Kjo marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët dhe është e vleshme 1 (një) vit nga momenti i nënshkrimit të saj.

Bashkëlidhur relacionit keni një kopje të draft marrëveshjes së bashkëpunimit!

Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të pronave dhe Strehimit

Meleqe Spahiu

Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Gentian Dashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BEKAT  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2024

**MBI MIRATIMIN E MARËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME ASHK "PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE, BRENDA TERRITORIT TË BASHKISË, NË ZONAT ME PRIORITET ZHVILLIMI URBAN DHE ZONAT INFORMALE BANIMI" DHE NJË SHITESË NË NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË BASHKISË BERAT, PËR MENAXHIMIN E PROCESIT**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64 gërma “c”; ligjin 111/2018 ”Për kadastrën”, ligjin 20/2020 ”Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH ”, ligjin nr.107/2014 ” Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ” i ndryshuar dhe ligjin 90/2012 ”Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Vendimin nr. 797, datë 20.12.2023 “Për miratimin e Strukturës, Organigramës së Administratës së Bashkisë dhe të Njësive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat” për vitin 2024”, VKB nr. 87, datë 18.12.2021 “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Berat dhe Njësive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat”, i ndryshuar dhe VKM-së, nr. 435, datë 26.06.2024;

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me ASHK "Për legalizimin e ndërtimeve paleje, brenda territorit të Bashkisë Berat, në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale banimi".
2. Të miratojë shtesë personeli në strukturën e Bashkisë Berat me 2 (dy) specialistë për menaxhimin dhe administrimin e procesit të bashkëpunimit.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe

Shërbimeve, Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ervin CECA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE ,PRONAVE TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

## RELACION

### MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME EKB "MBI ZBATIMIN E PROGRAMIT PËR NDËRTIMIN E NJË BANESË ME KOSTO TË ULËT NË BASHKINË BERAT "

#### Të nderuar Këshilltare !

Në kuadër të mbështetjes dhe zbatimit të politikave të strehimit për kategorinë e shtresave në nevojë për strehim , që Bashkia Berat ofron në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Entin Kombëtar të Banesave, mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore " , pikës 1, 2 , të nenit 44 dhe 45 të ligjit nr.22/2018 ” Për strehimin social ”, i ndryshuar,Vendimin e Këshillit Drejtues të EKB nr.25,datë 27.06.2024

" Mbi miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit " Mbi zbatimin e programit për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë Berat " po ju sjellim për miratim draftin e marrëveshjes të dërguar nga ana e EKB me shkresën nr.410/4,datë 15.07.2024 .

Qëllimi i marrëveshjes është të përcaktojë angazhimin e ndërsjellë të Bashkisë Berat dhe Entit Kombëtar të Banesave , për një bashkëpunim dypalësh në funksion të përcaktimit të fushave , masave dhe mënyrave të bashkëpunimit.

Objekt i akt-marrëveshjes është financimi dhe ndërtimi nga EKB i një objekti banimi me 8 kate dhe një kat parkimi nëntokë.

Bashkia Berat si palë e kësaj marrëveshje vë në dispozicion të EKB truallin ku do të ndërtohet objekti i banimit me nr.24/227 Lajga ” 30Vjetori”, Zona Kadastrale 8502 si dhe disa detyrime të tjeera të cilat janë shprehur në mënyrë të detajuar te neni 3 i marrëveshjes.

Miratimi i kësaj marrëveshje nga ana Juaj dhe më pas nënshkrimi nga Kryetari i Bashkisë është hapi i parë që EKB të vazhdojë më tej me procedurat për zbatimin dhe përfundimin sa më shpejt të këtij projekti.

Bashkëlidhur relacionit keni një kopje të draftit marrëveshjes së bashkëpunimit!

Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të pronave dhe Strehimit

Meleqe Spahiu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROJEKTVEËNDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2024

**MBI MIRATIMIN E MARËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME EKB "MBI ZBATIMIN  
E PROGRAMIT PËR NDËRTIMIN E NJË BANESË ME KOSTO TË ULËT NË  
BASHKINË BERAT "**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64 gërma "c"; pikës 1, 2 , të nenit 44 dhe 45 të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", Vendimin e Këshillit Drejtues të EKB Nr.25, datë 27.06.2024 " Mbi miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit " Mbi zbatimin e programit për ndërtimin e banesave me kosto te ulët në Bashkine Berat "

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me EKB " Mbi zbatimin e programit për ndërtimin e banesave me kosto te ulët në Bashkine Berat ".
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi , ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile , Pronave,Transportit dhe Shërbimeve, Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave si dhe Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ervin CECA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA BERAT

Berat më \_\_\_\_/\_07\_/2024

### RELACION

#### PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 60 DATË 21.12.2023 " PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2024 DHE PBA 2024-2026 " i ndryshuar

Të nderuar këshilltarë !

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54, gërma "dh", neni 64 gërma "c", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar , të ligjit nr. 97/2023 "Për Buxhetin e vitit 2024", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit plotësues nr. 1 datë 24.01.2024 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024"; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 60 datë 21.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026" i ndryshuar, propozojmë që në VKB nr. 60 datë 21.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026" i ndryshuar , të bëhet rishikimi për rishpërndarje të fondeve në buxhetin e vitit 2024 të njësive shpenzuese si më poshtë :

#### 1. Bashkia Berat (qendra)

Njësia shpenzuese Bashkia Berat (qendra) kërkon të rishpërndajë për shpenzime operative shumën 100,000 lekë nga programi buxhetor AA102 Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse në programin buxhetor AC102 Arsimi & Kujdesi Social, si më poshtë :

##### Pakësime

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		Bashkia Berat (Aparati)	PAKËSIME			100,000
		AA102	Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse			100,000
2102001	01	AA102	V111AAD	602	Mirëmbajtja e Infrastrukturës dhe Funkcioni i Aparatit të Bashkisë	100,000

##### Shtesa

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		Bashkia Berat (Aparati)	SHTESA			100,000
		AC102	Arsimi & Kujdesi Social			100,000
2102001	01	AC102	V014AAB	606	Transferta për Buxh. Familje & Individë , raste që trajtohen me ndihmë ekonomike nga bashkia	100,000

## 2. Agjencia e Shërbimeve Publike

Njësia shpenzuese Agjencia e Shërbimeve Publike ka paraqitur kërkesë për ndryshime në programin buxhetor AB102 ( Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile).

Rishpërndarja e shpenzimeve kërkohet të bëhet duke kaluar fonde të kursyera nga procedura prokurimi të zhvilluara gjatë periudhës 6-mujore, në shpenzime kapitale.

Të pakësohet plani i shpenzimeve për shpenzime operative në shumën 2,400,000 lekë ( si fonde të kursyera nga procedura e prokurimit) dhe ky fond të përdoret për :

- Blerje Shtëpiza prej druri, shuma 1,200,000 lekë, në përgjigje të kërkesave të shumta nga bizneset për Shtëpiza prej Druri për të promovuar dhe shitur produktet e tyre në shëtitoren e qytetit me rastin e festave të fundit të vitit.
- Blerje pajisje dhe vegla pune, shuma 1,200,000 lekë të nevojshme për kryerjen e shërbimeve publike të gjelbërimt, mirëmbajtjes së rrugëve, varrezave, rrjetit të ndricimt.

### Pakësime

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102004		Agjencia e Shërbimeve Publike			PAKËSIME	2,400,000
		AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile			2,400,000
2102004	01	AB102	V452AAB	602	Mirëmbajtje rutinë e infrastrukturës rrugore rurale.	1,200,000
2102004	01	AB102	V626AAH	602	Mirëmbajtja rutinë dhe periodike e objekteve të ndryshme	500,000
2102004	05	AB102	V626AAH	602	Mirëmbajtja rutinë dhe periodike e objekteve të ndryshme	200,000
2102004	01	AB102	V626AAC	602	Rruge urbane e mirembajtur ne qytetetin e Berati	500,000

### Shtesa

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102004		Agjencia e Shërbimeve Publike			SHTESA	2,400,000
		AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile			2,400,000
2102004	01	AB102		602	Blerje shtëpiza prej druri	1,200,000
2102004	01	AB102		602	Blerje makineri dhe pajisje ,vegla pune	1,000,000
2102004	05	AB102		602	Blerje makineri dhe pajisje ,vegla pune	200,000

## 3. Drejtoria Arsimore Bashkia Berat

Njësia shpenzuese Drejtoria Arsimore Bashkia Berat ka bërë kërkesë për të rishpërndarë fondet për shpenzime kapitale brenda programit buxhetor AC102. Fondet e miratuara për shpenzime kapitale , 8,000,000 lekë ridetajohen në zëra shpenzimesh kapitale, të clat në kohën e miratimit të buxhetit vjetor (në muajin 12/23) nuk ishin parashikuar në sistemin e metodologjisë së re të pasqyrimt të shpenzimeve buxhetore. Gjatë kësaj periudhe të vitit 2024, nga Ministria e Financave janë hapur kodet e nevojshme për të gjitha produktet që janë kërkuar nga ana jonë.

Në këto kushte, kërkojmë ndryshimet si më poshtë :

**Pakësime**

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102005		<b>Drejtoria Arsimore Bashkia Berat PAKËSIME</b>				<b>8,000,000</b>
		<b>AC102</b>	<b>Arsimi &amp; Kujdesi Social</b>			<b>8,000,000</b>
2102005	05	AC102	P912AAP	231	Objekte të arsimit bazë dhe parashkollor të rikonstruara	7,300,000
2102005	05	AC102	P923AAH	231	Konvikte të rikonstruara	200,000
2102005	05	AC102	P043AAI	231	Objekte të shërbimit të kujdesit social për familje dhe fëmijë të mirëmbajtura	500,000

**Shtesa**

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102005		<b>Drejtoria Arsimore Bashkia Berat SHITESA</b>				<b>8,000,000</b>
		<b>AC102</b>	<b>Arsimi &amp; Kujdesi Social</b>			<b>8,000,000</b>
2102005	05	AC102	P912AAS	231	Blerje Kamionçinë me vetëshkarkim	2,500,000
2102005	05	AC102	P912AAP	231	Punime ndërtimi në mirëmbajtje të soletave, çative, mureve rrethues, ndarje ambientesh	1,000,000
2102005	05	AC102	P912AAT	231	Rikonstruksion Ndërtese njeve sanitare në kopshtin "Barrikada 2&3" dhe në Çerdhen nr. 5	700,000
2102005	05	AC102	P043AAJ	231	Rikonstruksion Ndërtese njeve sanitare në kopshtin "Barrikada 2&3" dhe në Çerdhen nr. 5	300,000
2102005	05	AC102	V043AAC	231	Blerje inventar ekonomik për çerdhet	200,000
2102005	05	AC102	V912AAB	231	Blerje inventar ekonomik për kopshtet	500,000
2102005	05	AC102	V912AAB	231	Blerje pajisje për zyrat	1,000,000
2102005	05	AC102	V912AAB	231	Blerje pajisje për ngrohje për institucionet arsimore	700,000
2102005	05	AC102	V912AAB	231	Blerje pajisje kuzhine për kuzhinat e kopshteve	500,000
2102005	05	AC102	V912AAB	231	Blerje vegla pune për stafin teknik	400,000
2102005	05	AC102	V923AAB	231	Blerje vegla pune për stafin teknik	200,000

Ju faleminderit !

**KRYETAR**  
Ervin DEMO

Sekretar i Përgjithshëm  
Arisa Toska

Drejtoria e Financës  
Rovena Shehu

Drejtoria Juridike  
Petro Sinjari

Agjencia e Shërbimeve Publike  
Joana Melëngu

Drejtoria Arsimore Bashkia Berat  
Klodiana Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE  
FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA Z. ADRIATIK SELIMLLARI

Drejtorja e Shërbimit Social dhe Drejtorja e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga Znj.Hene Selimllari, Nr. 4036 Prot, datë 23.07.2024, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c, ligjin 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqërore komunitare e rezidenciale, kriteret procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e tyre për shpenzime personale për përfitusit e shërbimit të organizuar”, VKB nr.60 datë 21.12.2023 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026”.

JU RELATOI:

Të nderuar këshilltarë,

Familja **Selimllari** jetonë në lagjen nr. 1 “Çlirim”, Rruga: “Ymer Berati”, në katin e parë të një pallati ekzistues, banesa në të cilën jetonë familja në bashkëpronësi është e tipologjisë 2+1 me orendi dhe kushte minimale, ku ndër vite nuk është bërë investim. Në këtë banesë jetojnë dy bashkëshortët z. Adriatik Selimllari dhe znj. Hene Selimllari (bashkëngjitur gjeni çertifikatën familjare).

Prej më shumë se 20 vite familje Selimllari është trajtuar me ndihmë ekonomike, ku aktualisht përfitojnë 3.703 (tre mijë e shtatëqin e tre) lekë (bashkëngjitur gjeni vërtetimin). Përpost vshtrësive social-ekonomike që ka familja për tu integruar në tregun e punës si pasojë e moshës së madhe dhe problemeve shëndetësore, ata kanë dhe konflikte ligjore ku ju është marrë toka përfituar nga ligji nr. 7501. Toka ishe nga ato pak mundësi që familja Selimllari kishtë për të plotësuar nevojat bazike ushqimore, ku prej më shumë se tre vitesh është duke ndjekur proceset gjyqësore për ta rrimarë.



Strukturat e Shërbimit Social e kanë identifikuar, trajtuar dhe mbështetur familjen Selimllari prej shumë kohësh si familje në nevojë me kushte të vështira social-ekonomike nga projekte të ndryshme implemtuar nga OJF-të si dhe nga politikat lokale sociale zbatuar nga kjo drejtori. Mbështetja ka konsistuar në paketa ushqimore dhe higjenosanitare si dhe nga projekte të ndryshme rehabilituse me fokus integrimin e familjeve në nevojë. Por kjo familje vazhdimisht e ka pasur të vështirë për tu integruar në tregun e punës si pasojë e moshës së madhe problemeve social/ekonomike/shëndetësore dhe mungesës së një profesioni nga të dy bashkëshortët.

Për të mos mjaftuar situata e vështirë social-ekonomike e krijuar ndër vite si pasojë e mungesës së theksuar të të ardhurave, kryefamiljari z. Adriatik Selimllari në Maj 2024 i nënshtrohet një operacioni kirurgjikal të vështirë (herniatomi e shoqëruar me plastik), ku në të njëjtën kohë z. Selimllari prej vitesh vuan edhe nga tensioni arterial i theksuar (bashkëngjitur gjeni dokumentacionin shëndetësor).

Faza post operatore për z. Selimllari ka qenë tepër e vështirë duke parë vështirësit ekonomike që ka për të siguruar medikamentet e nevojshme të tilla si : fraksipirinën (hollusin e gjakut), si dhe medikamentet qetësuse që nuk janë të rimbursueshme.

Situata e krijuar i ka rënduar stabilitetin e tij shëndetësor pasi ai shpeshë herë nuk arrin të mundësojë medikamentet që i ka të domosdoshme për rehabilitimin e tij të plotë shëndetësor, pasi farmacit nuk e mbështetin për një kohë të gjatë pa pagesë.

*Të ndodhur në këto kushte duke u bazuar dhe në kerkesën e bërë nga familja, vlerësimin social-ekonomik mbi nevojat nga strukturat e shërbimit social, vështirësin social-ekonomike, kushtet ku jetonë familja dhe dokumentacionin e paraqitur propozojmë që z. Adriatik selimllari të mbështetet në masën e 100.000 (njëqind mijë) lekë .*

Bashkëngjitur gjeni:

1. Dokumentacion shëndetësor.
2. Çertifikatë familjare/ kopje të ID kartave .
3. Vërtetimi mbi masën e ndihmës ekonomike.
4. Vlerësimi social-ekonomik nga administrator i N.E.

**DREJTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKT- VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE  
FINANCIARE NË RASTE TË VEÇANTA Z. ADRIATIK SELIMLLARI**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24/1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c, ligjin 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqërore komunitare e rezidenciale, kriteret procedurat për përfitim të tyre dhe masën e tyre për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, VKB nr.60 datë 21.12.2023 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026”.

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në raste të veçanta, për shtetasen Adriatik Selimllari në shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë.
2. Shuma prej lekë 100.000 (njëqind mijë) lekë, do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2024.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

Ervin Ceca

Këshilli i Bashkisë e miratoi me : \_\_\_\_ Vota Pro, \_\_\_\_ Vota Kundër, \_\_\_\_ Vota Abstenim



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK**

**RELACION**

**MBI MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027**

Të nderuar këshilltarë!

Në përputhje me nenet 4 dhe 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshur dhe ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore”, dhe Udhëzimit nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësisive të vetëqeverisjes vendore ” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 3 datë 28.02.2024 “ Për përgatitjen e PBA vendor 2025-2027”, si edhe Udhëzimit Plotësues nr. 8 datë 05.07.2024 “Për përgatitjen e PBA Vendor 2025-2027”, ju sjellim për miratim tavanet përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027.

Sipas udhëzimit plotësues nr 8 datë 05.07.2024“Për përgatitjen e PBA Vendor 2025-2027”, :

I. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027 :

- Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027, të miratuara nga Këshilli i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore do të merren në konsideratë për hartimin e buxhetit të vitit 2025.
- Parashikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore do të mbështetet në legjislacionin aktual në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore, si dhe në ligjin nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar.
- Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transferata e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2025, do të jenë në përputhje me nivelin e financimit të miratuar në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2025-2027, sipas detajimit të parashikimit të dërguar në fazën e parë të PBA-së për vitet 2025-2027.  
Efekti i rritjes së pagave për funksionet e financuara me transfertë sektoriale dhe për punonjësit e administratës së bashkisë do të reflektohet në transfertën që do t’i akordohet njësisive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2025.
- Niveli i transfertës së pakushtëzuar dhe i transfertës së pakushtëzuar sektoriale për vitet 2025-2027, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në pushtetin vendor deri në vitin 2024. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar/pakushtëzuar sektoriale do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës financiare përkatëse.
- Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2025-2027 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41 datë 24.01.2024, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027. Ai pasqyron parashikime të treguesve ekonomik dhe financiar të buxhetit të njesisë së vetëqeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK**

të burimeve që njësia e vetëqeverisjes vendore do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.

- Këto vlerësime sigurojnë bazën për njësitë e vetëqeverisjes vendore për të përcaktuar tavanet e shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm.
- Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore duhet të përfshijnë në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 planin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.
- Procesi i miratimit të PBA-së 2025-2027 përfundimtare dhe Buxhetit Vjetor, do të realizohet nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor.
- Programi Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 duhet të hartohet në përputhje me programet e miratuara me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar.
- Bashkitë: Korçë, Gjirokastër, Mirditë, Berat, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shkodër, Shijak dhe Belsh, do të vijojnë me fazën e dytë të PBA-së sipas sipas metodologjisë së re të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave nr.3 datë 28.02.2024.

## II. Afatet për Përgatitjen e Buxhetit

- Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga buxheti i shtetit, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.
- Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik.
- Brenda datës 15 shtator, njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësisë.
- Ministria e Financave zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 tetor. Në përfundim të këtyre takimeve, sipas rastit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm, brenda datës 20 tetor.

Në këto kushte, në këtë fazë nuk kemi ndryshime në burimet e të ardhurave. Kemi ruajtur të njëjtat tavane të shpenzimeve për PBA 2025-2027, me ato të miratuara në fazën përgatitore.

## Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Për Bashkinë Berat është parashikuar kjo ndarje e transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme :

○ Për vitin 2025 , shuma 443,078 mijë lekë

Në krahasim me vitin 2024 transfertata është parashikuar me rritje + 25,001 mijë lekë, ose +6%.

○ Për vitin 2026 , shuma 469,991 mijë lekë

Në krahasim me vitin 2025 transfertata është parashikuar me rritje + 26,913 mijë lekë, ose +6%.

○ Për vitin 2027 , shuma 499,028 mijë lekë

Në krahasim me vitin 2026 transfertata është parashikuar me rritje + 29,037 mijë lekë, ose +6%.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK**

### **Transferta e pakushtëzuar sektoriale**

- Transferta e pakushtëzuar sektoriale parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2025-2027, për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara tek bashkitë në vitin 2016. Sipas akteve ligjore në fuqi funksionet e transferuara janë: personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, shpenzimeve për investime do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës. Bashkitë mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për çdo funksion të transferuar.
- Transferta e pakushtëzuar sektoriale për periudhën 2025-2027, do të jetë 1% më e lartë për çdo vit buxhetor.
- Është parashikuar për çdo vit Transferta e pakushtëzuar sektoriale për rritjen e nivelit të pagave prej 51,667 mijë lekë.

### **Transferta e kushtëzuar**

- Transferta e kushtëzuar parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2025-2027, për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Shuma e transfertave të kushtëzuara do të jetë rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, dhe shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës.

### **Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore**

- Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, si burim financimi i funksioneve të bashkisë, për periudhën 2025-2027 parashikohen të jenë :  
për vitin 2025 parashikohen të jenë 637,974 mijë lekë,  
për vitin 2026 parashikohen të jenë 646,481 mijë lekë, me rritje + 8,507 mijë lekë në krahasim me vitin 2025 ose +1.3% ;  
për vitin 2027 parashikohen të jenë 651,974.690 mijë lekë, rritje + 5,493 mijë lekë në krahasim me vitin 2026 ose +0.8%.

Bashkëngjitur, për miratim tabelat e tavaneve përfundimtare për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027.

Ju faleminderit !



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK**

**GRUPI I MANAXHIMIT STRATEGJIK**

Ervin	DEMO	Kryetar i Bashkisë ( NA )
Arisa	TOSKA	Sekretar i Përgjithshëm ( Koordinator )
Rovena	SHEHU	Drejtor i Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave ( Sekretar i GMS)
Joana	MELËNGU	N/Kryetar i Bashkisë
Etleva	DHIMA	N/Kryetar i Bashkisë
Marius	QYTYKU	Drejtor i Integritimit Europian dhe Planifikimit Strategjik
Sokol	TOSKA	Drejtor i Taksave dhe Tarifave
Gentian	DASHI	Drejtor i Burimeve Njerëzore
Petro	SINJARI	Drejtor i Drejtorisë Juridike
Silvana	MERDANI	Drejtor i Turizmit dhe Aktiviteteve
Kreshnik	ZAIMI	Drejtor i Policisë Bashkiake
Artan	MERKO	Drejtor i repartit të MZSH
Piro	XHEBLATI	Drejtor i Shërbimit Social
Majlinda	RAMA	Drejtor i Arsimit, Kulturës dhe Rinisë
Joana	MELËNGU	Drejtor i NJSH Agjencia së Shërbimeve Publike
Bledar	ÇILI	Drejtor i NJSH Drejtoria e Bujqësisë, administrim pyje, ujëra e shërbim veterinar
Klodiana	HOXHA	Drejtor i NJ.SH. Drejtoria Arsimore
Arben	QAFA	Drejtor i NJ.SH. Qendra Kulturore “ Margarita Tutalani”
Alma	KULE	Drejtor i NJ.SH. Qendra “LIRA”

**Raporti: PBA1 - Tavanet Përfundimtare të PBA**NJVQV 102 - Bashkia Berat  
:  
2025 - 2027

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	2025	2026	2027
<b>AA102 - Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	98,550	99,550	100,530
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651)	71,955	75,200	79,164
Shpenzime Kapitale të Brendshme (230-232, 255, 1661)	2,602	2,500	2,000
Shpenzime Kapitale të Huaja (230-232)	0	0	0
<b>Tavanet e Përgjithshme</b>	<b>173,107</b>	<b>177,250</b>	<b>181,694</b>
<b>AB102 - Shërbimet Publike, Infrastruktura &amp; Emergjencat Civile</b>			
Shpenzime Personeli (600-601)	131,032	132,350	133,665
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651)	270,872	274,857	296,845
Shpenzime Kapitale të Brendshme (230-232, 255, 1661)	128,000	144,286	206,232
Shpenzime Kapitale të Huaja (230-232)	0	0	0
